

Iniciativa feministe sfidon

Ne sfidojmë imazhin kombëtar ndaj vetës sonë në Suedi si një shtet i barabartë dhe i hapur i cili i respekton të drejtat e njeriut. Të njëjtin imazh i cili thotë se kush është suedez është i barabartë, i hapur dhe tolerant.

Ne tregojmë një imazh tjetër – i ndërtuar mbi fakte, studime dhe dituri ku Suedia dhe suedezët jo rrallëherë paraqiten si jo të barabartë, të hapur dhe vend ku respektohen të drejtat e njeriut.

Ne sfidojmë partitë politike tradicionale të cilat pohojnë se politika e tyre është e mjaftueshme. Përmirësime të vogla aty-këtu nuk mjaftojnë. Është e nevojshme për ndryshme rrënjësore.

Iniciativa feministe është një parti inovative e cila vepron në peizazh të vjetër politik patriarkal.

Kur partitë e tjera e shfrytëzojnë feminizmin si një melmesë të një pikënisje veq të formuluar, ne zgjedhim që vet feminizmi të të jetë pikënisja. Ne jemi një parti shpërthyesë në një peizazh politik ku partitë tradicionale nuk janë të afta të zvogëlojnë diskriminimin dhe pabarazinë.

Iniciativa feministe e sfidon politikën e rrënjësor e majtë – e djathtë me propozimet më të guximshme dhe më të avancuara kundër pabarazisë dhe të gjitha formave të diskriminimit.



Zëdhënëset tona të partisë

Gudrun Schyman, Simrishamn
Sissela Nordling Blanco, Stockholm
Stina Svensson, Göteborg

A do të dish më shumë?

Nëse do të dish më shumë rreth politikës sonë apo zëdhënësve atëherë hy në www.feministiskinitiativ.se, ose dërgo një email në info@feministiskinitiativ.se

Bëhu anëtar!

Më shumë anëtarë peshojnë më shumë. Ti nevojitesh! Paguaje tarifën e antarësisë nga 50 – 500 korona (ti vendos për shumën varësisht nga mundësitë tuaja) në pg 40 57 53-5. Shkruaje "Medlem" si dhe emrin, adresën dhe e-mailin.

Dhuro një donacion!

Ne nuk marrin ndihmë financiare partiake andaj puna jonë politike bazohet në donacionet e qytetarëve dhe tarifën e antarësisë. Paguaj një shumë sipas dëshirës në xhiron plus pg 40 57 53-5. Shkruaje "Gåva"



sfidon

Iniciativa feministe
Një dimenzion i ri në politikë



FI e sfidon imazhin e Suedisë si vend i ...

... barabartë

Të gjitha partitë deklarojnë se janë për barazi gjinore por faktet dhe statistika dëshmojnë se Suedia është shumë larg barazisë gjinore. Barazia gjinore nuk është një pikëpamje për një çështje diturie, një objektivë politike. Iniciativa feministe i vë në dukje strukturat dhe modelin e pushtetit që e pengon barazinë. Ne propozojmë masa rrënjësore për ndryshime.

Çka shohim ne?

Ne shohim se puna e femrave akoma vlerësohet më ulët sesa e meshkujve. Paga për orar të plotë pune e femrave është mesatarisht 4 400 kr më e ulët në muaj sesa e meshkujve. Paga e ulët jep të ardhura më të ulëta në rast papunësie, kompensim të ulët prindëror dhe ne fund edhe pension të ulët. Poashtu java 40 orëshe e punës kushtëzon që shumë femra të punojnë me orar të pjesërishtë për të arritur që të kujdesen për shtëpinë, fëmijët dhe pleqtë. Në të njëjtën kohë baballarët me fëmijë të vegjël punojnë më shumë orë sesa çdo grup tjetër.

Çka duam ne?

Ne duam të themelojmë një fond të barazisë gjinore për të rrafshuar dallimet në paga në mes të sektorëve të ndryshëm dhe do i japim një direktivë Institutit për Ndërmjetsim të Pagave për paga më të barabarta. Ne duam të individualizojmë sigurimin prindëror dhe të realizojmë një shkurtrim të përgjithshëm të orarit të punës. Kjo jep një ndarje më të

... hapur

Shpesh paraqiten problemet me racisëm dhe homofobi si probleme të vogla prapa të cilave qëndrojnë forcat ekstreme të djathta. Por diskriminimi është struktural dhe ekziston në të gjitha pjesët e shoqërisë suedeze. Iniciativa feministe ka propozime për masa rrënjësore për ndryshime.

Çka shohim ne?

Ne shohim se si kufinjët krijojnë një ndarje në "ne" dhe "ata" ku "ne" vlerësohet më lart ku "ata" nuk përfshihen. Personat e racës së bardhë me emra që "tingëllojnë suedisht" e kanë më të lehtë për të gjetur punë dhe banesa. Ne shohim se si shumë familje bien jashtë normës së familjes së ngushtë dhe andaj nuk e gëzojnë ndihmën e shoqërisë dhe të ligjit. Prindërit e vetëm që kanë vështirësi për të mbajtur veten dhe fëmijët e vet dhe familjet e ylbarta të cilat diskriminohen, janë vetëm disa shembuj.

Çka duam ne?

Për të luftuar diskriminimin ekzistues etnik dhe struktural në tregun e punës ne duam të fusim masa afirmative. Ne poashtu duam të përshtatim legjislacionin sipas të gjitha formave të familjes dhe të relacioneve – familje të ylbarta, prindër të vetëm, familje të rikrijuara dhe kolektivit – e jo vetëm familje e ngushtë.

... respekton të drejtat e njeriut

Suedia shpesh kritikohet nga organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut por megjithatë nuk bëhet ndonjë përmirësim. Iniciativa feministe do të ushtroj presion në mënyrë që të respektohen të drejtat e njeriut

Çka shohim ne?

Bota sot është e ndarë dhe karakterizohet nga padrejtësi të shumta. Shumë njerëz largohen nga vendet e veta ose ikin për të kërkuar mbrojtje dhe një jetë më dinjitoze në një vend tjetër. Gara globale për armatim i vjedh të hollat për mirëqenie sociale gjithkund në botë. Dhuna në forma të ndryshme e burrave ndaj femrave është një problem i politikës së sigurisë.

Çka duam ne?

Vizioni ynë është një botë pa kufij. Një hap në këtë drejtim është që refugjatëve ta fshehur dhe pa letra tu jepet leje qëndrimi në Suedi. Një hap tjetër është që të garantohet një proces i sigurt ligjor në procesin e azilit që i merr parasysh arsyet e posaçme të ikjes që mund t'i kenë femrat dhe personat lgbt. Ne duam të veprojmë për një zhvillim të sigurisë globale njerëzore dhe për këtë arsye të ndalohet gara në armatim dhe eksporti i armëve. Ne duam në investojmë në masa që luftojnë dhe parandalojnë dhunën në familje.